



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 43 AKTI

NR. 27 VENDIMI

Tiranë, më 25.06.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Xhensila Pine	Kryesuese
Valbona Sanxhaktari	Anëtare
Etleda Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, dhe në prezencë të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, sot më datë 25.06.2018, ora 11:00, në Pallatin të Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Brikena Ukperaj (Lubonja)**, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D** të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi, vëren:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Znj. Brikena Ukperaj (Lubonja) është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “Ligji nr. 84/2016”).
2. Në bazë të pikës 11 të nenit 179 të Kushtetutës, duke qenë se znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), ka kandiduar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit menjëherë, duke u shortuar më datë 30 nëntor 2017 me trup gjykues nr. 4, të përbërë nga:
 - Valbona Sanxhaktari Komisionere;
 - Xhensila Pine Komisionere;
 - Etleda Çiftja Relatore.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”) sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”) sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”) sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. **Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “Komisioni”), me vendimin nr. 1/4, datë 12.12.2017,** të trupit gjykues nr. 4, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, për të tria kriteret, (i) vlerësimin e pasurisë; (ii) kontrollin e figurës dhe (iii) vlerësimin profesional, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesuesin e trupit, znj. Xhensila Pine; të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. **Më datë 13.06.2018,** trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës për shpjegime të mtejshme mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
6. **Më datë 07.06.2018,** subjekti i rivlerësimit u njoftua me anë të postës elektronike për përbërjen e trupit gjykues, si dhe u njoftua se ka të drejtë të deklarojë konfliktin e interesit me anëtarët e trupit gjykues. Subjekti i rivlerësimit, po në të njëjtën ditë ktheu përgjigje me

anë të postës elektronike ku deklaroi se në dijeninë e saj nuk ishte në konflikt interesi me asnjë prej komisionerëve.

7. **Më datë 13.06.2018**, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës për të dhënë shpjegime sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.
8. **Më datë 18.06.2018**, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike, solli shpjegimet e saj së bashku me provat, të cilat u administruan nga ana e Komisionit.
9. **Më datë 20.06.2018**, trupi gjykues nr. 4, me anë të vendimit nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 22.06.2018, ora 11:00 paradite, në Pallatin e Kongreseve, kati i 2-të, Tiranë.
10. **Më datë 22.06.2018** u zhvillua seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), ku ajo kërkoi konfirmimin në detyrë. Pasi trupi gjykues dëgjoqi qëndrimin e subjektit të rivlerësimit në lidhje me procesin e rivlerësimit, ndërpreu seancën dëgjimore për ta rifilluar më datë 25.06.2018, ora 11:00 paradite, për shpalljen e vendimit.
11. **Më datë 25.06.2018**, trupi gjykues e deklaroi të mbyllur seancën dëgjimore dhe shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

II. BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, SIPAS NENIT 48 TË LIGJIT NR. 84/2016

12. Gjatë të gjitha fazave të hetimit, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

III. SEANCA DËGJIMORE

13. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore më datë 25.06.2018. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 25.06.2018, ora 11:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.
14. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezente, ajo dha shpjegimet e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, kërkoi konfirmimin në detyrë.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

15. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke kryer procesin e rivlerësimit mbi bazën e 3 kritereve të parashikuara në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016:
- Për vlerësimin e pasurisë;
 - Për kontrollin e figurës; dhe
 - Për vlerësimin e aftësive profesionale.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Në lidhje me procesin e rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim bazuar në:

16. *Raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar të Inspektoratit të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI), sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit 84/2016*

Me shkresën nr. ***, datë 09.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, me numër indeksi 7645 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2006 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting” më datë 25.01.2017.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, konstatohet se për subjektin Brikena Ukperaj:

- deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
 - ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
 - nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - nuk ka kryer deklarim të rremë;*
 - subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
17. *Hetimi administrativ i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për rivlerësimin e kriterit të vlerësimit të pasurisë*

Pavarësisht se, sipas kreut IV të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë

vendim në lidhje me vlerësimin pasuror të subjektit, Komisioni duhet të kryejë hetimin e tij të pavarur¹.

Prandaj, deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistoi në verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, si dhe verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në “Deklaratën e Pasurisë për Procesin e Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, si dhe deklaramet e bëra me anë të postës elektronike, *e-mail*, Komisioni ka administruar prova shkresore nga: institucionet financiare bankare dhe jobankare; zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme; Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve; Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë; Instituti i Sigurimeve Shoqërore; Qendra Kombëtare e Biznesit; Ministria e Drejtësisë; Noteri Publik, për dokumentacion në lidhje me subjektin; dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë; shoqëri tregtare; Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), Ujësjiellës-Kanalizime (UKT) etj., që vërtetojnë veprime dhe fakte për realizimin e hetimit sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Hetimi nga ana e Komisionit përfshiu verifikimin e të gjitha deklaramëve të subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur/bashkëshortit dhe personave të tjerë të lidhur/nënës dhe babait të subjektit, për sa më poshtë:

18. Apartament me sipërfaqe 106.85 m², në *, Tiranë, pas ndarjes së re administrative, Rr. “***”, Njësia Administrative ***, Tiranë, i përfituar me anë të të ardhurave të siguruara nga kontrata e kredisë bankare, nr. ***, datë 25.5.2012, lidhur me bankën “BKT” dhe 9000 euro të marra hua nga prindërit e subjektit. Vlera: 44.877 euro. Pjesa që zotëron: 50 % subjekti dhe 50 % bashkëshorti.**

Hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni u përqendrua në analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie dhe nëse këto burime ishin nga të ardhurat të ligjshme.

Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë² konfirmon pasurinë ***, vo1. ***, fq. ***, ZK ***, lloji i pasurisë apartament, me sip. 106,85 m², në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit, D.U. Subjekti dhe bashkëshorti kanë lidhur kontratën e shitjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.05.2012, në vlerën 44.877 euro. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe në Deklaratën-Vetting.

Më qëllim hetimin e burimeve të krijimit, iu kërkua Bankës Kombëtare Tregtare informacion, nga i cili rezultoi se ekziston një kontratë kredie bankare, nr. ***, me BKT-në, për vlerën 5.026.224 lekë, që subjekti i rivlerësimit së bashku me personin e lidhur/bashkëshortin kanë nënshkruar.

Në lidhje me burimin tjetër, në vlerën 9000 euro, të marrë hua nga prindërit, Komisioni për shkak të kësaj marrëdhënie huaje, shtriu hetimin e tij dhe te prindërit e subjektit të rivlerësimit

¹ “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

² Shkresat nr. ***, datë 19.01.2018 dhe nr. ***, datë 06.02.2018 të ZVRPP-së Tiranë në dosje

z. S.L dhe znj. O.L, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, për të vërtetuar aftësitë e tyre financiare dhe burimet e ligjshme të këtyre të ardhurave që i janë dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

Nga hetimi për aftësinë financiare të prindërve, z. S dhe znj. O.L, rezultoi se ata kishin të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të dhënë huan prej 9000 eurosh subjektit të rivlerësimit, vërtetuar kjo me dokumentacion provues të dërguar nga shteti grek³.

Komisioni hetoi dhe në lidhje me një dyshim që kishte për kohën e tërheqjes së shumës prej 8.500 eurosh në bankën greke, nga ku rezultonte se data e pagesës në kontratë nuk përputhej me datën e tërheqjes. Për këtë fakt iu kërkuan shpjegime subjektit të rivlerësimit, e cila sqaroi se shuma prej 8.970 eurosh nuk u është dhënë shitësve në datën e lidhjes së kontratës së shitjes me kusht, apo më parë, por rreth 1 muaj më pas, bazuar në kushte e mirëbesimit dhe lidhjes gjinore (pasi njëri prej dy shitësve të apartamentit, z. Th. Ç, është daja i subjektit të rivlerësimit), dhe në fakt kjo shumë iu shlye shitësve në fund të muajit maj, datë që korrespondon me tërheqjen e parave nga personi i lidhur/e ëma e subjektit të rivlerësimit, vërtetuar kjo me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.06.2018, të shtetasve Th. Ç dhe A. R, mbajtur përpara noterës ***, në të cilën dy shitësit e apartamentit kanë deklaruar se vlerën prej 8.970 eurosh e kanë marrë në dorë, *cash*, jashtë zyrës noteriale, në fund të muajit maj 2012.

Më tej, Komisioni analizoi të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në lidhje me aftësinë paguese të kredisë dhe, nga analiza financiare rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë të ardhura nga burime të ligjshme për të paguar kredinë e marrë.

19. Automjet tip “Mercedes-Benz”, C 220 CDI, me targë *, i përfituar në bazë të kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 01.07.2010, me të ardhura të siguruara nga shitja e pasurisë së luajtshme në pronësi vetjake të bashkëshortit. Vlera: 7.500 euro. Pjesa që zotëron: 30 % subjekti dhe 70 % bashkëshorti.**

Hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni u përqendrua në analizimin e burimeve të krijimit të këtij asemi dhe nëse këto burime të krijimit ishin nga të ardhurat e ligjshme.

Gjatë hetimit administrativ të Komisionit, më konkretisht shkresa e ardhur nga DPSHTRR-ja, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. D.U, ka të regjistruar automjetin me targë ***, “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2009, tipi 212, modeli E 350 CDI. Në të njëjtën shkresë konfirmohet se nuk ka automjete të tjera të regjistruara në emër të subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur/bashkëshortit.

³ “Deklaratë noteriale datë ***, e lëshuar nga nëna ime, O.L, para noterit grek. (2 fletë, e përkthyer në shqip). Printim i lëvizjeve, në llogarinë bankare të “***” sh.a., Greqi, nga e cila janë nxjerrë një pjesë e këtyre të ardhurave (8.500 euro), Nr. i llogarisë së mamasë e motrës sime, të hapur pranë kësaj banke, më datë 14.11.2008, dokument origjinal me vulën e bankës, i përkthyer në shqip, nga rezultojn tërheqja e shumës 8.500 euro (gjithsej 2 fletë). Emri i motrës në llogarinë e mësipërme është bërë për lehtësim të procedurës së tërheqjes e depozitimit të të ardhurave. Kopje e lejeve të qëndrimit të mamasë në Greqi, nga viti 2003 e në vazhdim, ndërkohë që për periudhën e mëparshme të qëndrimit (prindërit kanë emigruar që nga viti 1992) emigrantët pajiseshin me karta “jeshile” (një prej të cilave e disponoj edhe unë për vitet e qëndrimit në Greqi para vitit 2001), të cilat pas mbarimit të afatit dorëzoheshin para autoriteteve përkatëse (gjithsej 5 fletë). Deklarime të të ardhurave të realizuara nga prindërit e mi, O dhe S.L, për efekt të tatimit mbi të ardhurat e siguruara në shtetin grek për vitet e punësimit: 2008 - 2012, por që deklaroheshin në vitin pasardhës (gjithsej 12 fletë), të lëshuara nga autoriteti përkatës, të përkthyer në shqip, bashkë me vulën e legalizimit për shkak se Greqia nuk është pjesë e Konventës së Hagës së 5 tetorit 1961: Për heqje të kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja”.

Nga hetimi rezultoi se ky automjet ishte blerë me anë të kontratës së shitjes të datës 07.07.2017, lidhur me personin fizik L. A, në vlerën 960.000 (nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë.

U analizuan burimet e krijimit të këtij automjeti, si: **1.** kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.05.2017, e automjetit “Mercedes-Benz”, ***, në vlerën 5000 euro; **2.** shuma prej 300.000 lekësh, gjendje në llogarinë bankare të pagës së subjektit më datë 07.07.2017, nga të cilat 199.900 (njëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) lekë kursime të deklaruara në vitin 2016, ndërsa 75.000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë kursime nga 01.01.2017 deri më 04.07.2017.

Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka të ardhura të mjaftueshme dhe burimi i krijimit të këtij automjeti është nga të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit.

Si përfundim, bazuar në sa më lart, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016.

20. Motomjet tip “Kimco”, c 200, viti i prodhimit 2009, blerë nga bashkëshorti më datë 15.06.2016, me faturë tatimore nr. * nga shitësi “****” sh.p.k.; i blerë me të ardhurat nga paga e të dyve, nga data 01.01.2016 - 15.06.2016 (bashkëlidhur deklaratës dokumentacioni justifikues). Vlera 27.372 lekë, zotëron 50 % secili bashkëshort.**

Hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni u përqendrua në analizimin e burimeve të krijimit të këtij asemi dhe nëse këto burime të krijimit ishin nga të ardhurat të ligjshme.

Gjatë hetimit administrativ të Komisioni, më konkretisht shkresa e ardhur nga DPSHTRR-ja, rezultoi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. D.U, disponon në pronësinë e tij motomjet me targë ***.

Pasi analizoi burimet e deklaruara të krijimit të këtij mjeti/motori, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit nga data 01.01.2016 - 15.06.2016, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti kishin të ardhura të mjaftueshme dhe me burime të ligjshme krijimi për blerjen e këtij motomjeti, vërtetuar kjo me vërtetimet e të ardhurave të depozituara pranë ILDKPKI-së.

21. Kontratë depozite në “BKT”, “Fëmija im”, e lidhur më datë 26.03.2014, me të drejtën e administrimit të depozitës, shtimit dhe tërheqjes së saj me titullar të llogarisë djalit D. U (i mitur), me datë maturimi 25.01.2028. E drejta e administrimit dhe tërheqjes ushtrohet për shkak të përgjegjësisë prindërore. Vlera më datë 23.01.2017, 197.644 lekë.

Hetimi kryesisht i kryer nga Komisioni u përqendrua në analizimin e burimeve të krijimit të kësaj depozite dhe nëse burime e krijimit ishin nga të ardhurat të ligjshme.

Banka Kombëtare Tregtare ka dërguar informacion se ekziston një llogari rrjedhëse në gjendjen që deklaroi subjekti i rivlerësimit. Komisioni analizoi burimin e ligjshëm të të ardhurave për krijimin e kësaj depozite.

Në përfundim, Komisionit i rezulton se kjo depozitë është krijuar nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur/bashkëshortit, vërtetuar kjo me anë të dokumentacionit provues të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit dhe analiza financiare e të ardhurave.

Si përfundim, bazuar në sa më lart, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin nr. 84/2016.

22. Pasuri të padeklaruar ose të fshehura

Komisioni, përveç hetimit mbi asete të deklaruar, kërkoi informacion pranë organeve publike dhe private për të evidentuar ndonjë mosdeklarim ose fshehje pasurie nga ana e subjektit të rivlerësimit, personit tjetër të lidhur/bashkëshortit dhe/ose personave të tjerë të lidhur/nënës dhe babait të subjektit të rivlerësimit.

Për subjektin e rivlerësimit nuk rezulton ndonjë pasuri e fshehur.

Për personin e lidhur/bashkëshortin rezulton se:

Nga regjistri i noterisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në vitin 2006 ka nënshkruar kontratën e porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.03.2006, me shoqërinë “***” sh.p.k., për një apartament me sip. 89.54 m², në katin IV të një godine banimi në Rr. “***”, në vlerën 53.724 (pesëdhjetë e tremijë e shtatëqind e njëzet e katër) euro. Kjo pasuri nuk është regjistruar ende në ZVRPP Tiranë, për shkak të bllokimit të aktivitetit të shoqërisë ndërtuese.

Nga hetimi i kryer rezultoi se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e kishte nënshkruar këtë kontratë para bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, vërtetuar kjo me anë të certifikatës martesore.

Pavarësisht kësaj, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se bashkëshorti ka vepruar si përfaqësues, në emër dhe për llogari të babait të tij, pasi prindërit e tij nuk jetonin në Tiranë, por në Has. Të gjitha veprimet i ka kryer i ngarkuar nga i ati, me mjete monetare që u përkisnin prindërve të tij, vërtetuar kjo me anë të aneksit të kontratës së porosisë nr. *** rep., datë 21.03.2006, nënshkruar ndërmjet sipërmarrësit N.B, porositësit Q.U (vjehtëri i subjektit të rivlerësimit) dhe përfaqësuesit të tij, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. D.U, autentifikuar nënshkrimi para noterit publik me dokumentin nr. *** rep., datë 02.12.2016. Më tej, kjo konfirmohet edhe nga korrespondenca me OSHEE-në⁴, e cila konfirmon se në emër të z. Q.U ka një kontratë në Rr. “***”, por ndryshimi i emrit në kontratë është bërë më datë 27.12.2016. Ndërsa UKT-ja⁵ konfirmon se z. Q.U ka një kontratë me UKT-në, por është ndryshuar emri nga D.U në Q.U më datë 24.01.2017.

Për personin tjetër të lidhur/babanë dhe nënën nuk rezultuan asete të padeklaruar sipas nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

Nga ana e Komisionit u identifikuan disa asete në emër të prindërve, por që ishin blerë para se subjekti i rivlerësimit të emërohej si gjyqtare.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ajo shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të

⁴ Shkresat nr. *** , datë 28.02.2018, nr. *** , datë 09.02.2018, në dosje.

⁵ Shkresa nr. *** , datë 07.02.2018, në dosje.

ardhurave, duke paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e këtyre pasurive dhe të ardhurave.

B. KONTROLLI I FIGURËS

23. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

24. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale të gjyqtarës Brikena Ukperaj rezulton se ajo ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 02.07.2004 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2007. Pas studimeve, në datën 14.11.2007 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Ndërsa më 21.11.2016 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Apelit Vlorë. Nuk konstatohet mospërputhje me të dhënat e deklaruara në Formularin e Vetëvlerësimit.

25. Sipas informacionit të marrë nga KLD-ja, janë analizuar dokumentet si më poshtë:

- Formulari i vetëdeklarimit;
- 3 dokumente ligjore dhe dokumente të tjera të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

26. Rivlerësimi nga Komisioni

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke u bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së;
- Informacionin e marrë nga burime të ligjshme;

- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Nga analizimi i sa më sipër, rezultoi se:

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore - Subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Analizon me kujdes normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Arsyetimi ligjor - 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë të shkruara qartë dhe në mënyrë të kuptueshme me strukturë të mirorganizuar; edhe mendimi i ndihmësit ligjor ka organizim më vete në formën e një minivendimi sipas natyrës së çështjeve që duhet të merren në konsideratë në zgjidhjen e çështjes së rekursuar. Në një rast tjetër, mendimi i ndihmësit ligjor nuk ka pika të përbashkëta me vendimin e Gjykatës, por gjyqtari në pakicë, pranë të cilit ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, ka dalë me mendim pakice, duke argumentuar mbi bazën e dispozitave ligjore dhe nënligjore kalimtare të zbatueshme në rastin konkret, të cituara në relacionin e ndihmësit ligjor.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë - Subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore të hartuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor.

Arsyetimi i vendimit është gjithëpërfshirës në raport me pretendimet e ngritura nga palët. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore në raport me faktin e mosmarrëveshjes të përcaktuar sipas provave të shqyrtuara. Jep arsye të qarta edhe kur nuk pranon pretendimet e palëve të ngritura në gjykim. Nga ana tjetër, me qëllim standardizimin e vendimeve ajo ka bërë pjesë të pothuajse çdo vendimi arsyetimin mbi juridiksionin, kompetencën lëndore dhe kompetencën tokësore, ndonëse ato janë çështje të qarta, të konsoliduara nga praktika gjyqësore dhe nuk janë kundërshtuar as nga palët (shih dosjet 2, 4 dhe 5).

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë - Gjyqtarja Brikena Ukperaj ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 02.07.2004 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2007. Në datën 14.11.2007 është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ndërsa në datën 21.11.2016 është emëruar gjyqtare në Gjykatën Apelit Vlorë, ku vazhdon aktualisht ushtrimin e detyrës.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Brikena Ukperaj. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Është e vërtetë që janë konstatuar 19 seanca gjyqësore të filluara me vonesë nga 4 minuta deri në 1 orë e 46 minuta, por kjo e dhënë është vlerësuar tek *Aftësitë organizative* të gjyqtarit, pasi nuk duket të jetë e lidhur me shkelje të disiplinës në punë.

Integriteti - Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia - Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj. Në 5 dosjet e vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Në 2 dosje është konstatuar se ajo ka shqyrtuar çështje për zgjidhjen e martesës midis bashkëshortëve me fëmijë të mitur, ku ka zbatuar dhe analizuar parimin e interesit më të lartë të fëmijës (shih dosjet 3 dhe 5), ku konstatohet një kujdes i veçantë i saj për të miturit. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të tjera të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste ku subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, nuk ka respektuar rregullat procedurale.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit - Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Brikena Ukepraj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje profesionale dhe etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

Aftësia për të bashkëpunuar - Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Brikena Ukperaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk ka pasur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi dhe se nuk ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, që tregon jo vetëm produktivitetin e punës së saj, por edhe bashkëveprimin normal me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore (shih të dhënat tek *Aftësitë organizative*).

Gatishmëria për t'u angazhuar - Subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, pas përfundimit të Shkollës së Magjistraturës, ka ushtruar funksionin si gjyqtare në fushën e së drejtës civile, familjare dhe penale, por nuk ka specializime në asnjë fushë të së drejtës. Për shkak të funksionit që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Vlerësimi i ankesave për subjektin e rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtaren Brikena Ukperaj është paraqitur vetëm 1 ankesë në Inspektoratin e KLD-së, në vitin 2016. Kjo ankesë është arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Brikena Ukperaj, gjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

27. Më tej, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, Komisioni kërkoi nga Inspektorati pranë KLD-së të kryente një vlerësim shtesë në lidhje me subjektin e rivlerësimit për 3 vendime të tjera, të identifikuar nga Komisioni gjatë hedhjes së shortit për këtë subjekt.

Komisioni, me shkresën nr. *******, datë 12.03.2018, ka kërkuar nga KLD-ja mendim të specializuar lidhur me tri vendime gjyqësore të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj

(Lubonja), që i përkasin periudhës së rivlerësimit të saj kalimtar, 08.10.2013 - 08.10.2016, dhe lidhen me veprimtarinë e saj gjyqësore si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

Nga mendimi i specializuar dërguar nga ana e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë rezulton se, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u analizuan vendimet e mëposhtme:

1. Vendimi nr. ***akti, datë regjistrimi 31.05.2012, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, kundër të pandehurit D.G., i akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve”, të parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal.
2. Vendimi nr. ***, datë regjistrimi 27.10.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, që i përket: paditës K.H. dhe A.H. kundër të paditurit A.K.K.P., Bashkia Lushnjë, F.T. me person të tretë “A.A.C” sh.p.k. dhe “***” sh.p.k., me objekt “Kundërshtim i vendimit të KK Pronave, Bashkia Lushnjë nr. ***, datë 22.08.1995, nr. ***, datë 25.04.2001 dhe detyrimin për njohje pronar në sip. e truallit 230 m², bazuar në nenin 163 të Kodit Civil dhe ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve”.
3. Vendimi nr. *** akti, datë regjistrimi 24.02.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, që i përket: paditës R.GJ., kundër të paditurve GJ.GJ. etj., me objekt “Pjesëtim pasurie trashëgimore në bashkëpronësi”, bazuar në nenin 207 të Kodit Civil.

Nga hetimi dhe mendimi i KLD-së rezultoi se vendimi gjyqësor nr. ***, datë 17.12.2013, është lënë në fuqi nga gjykatat më të larta, në pozita më të favorshme për të pandehurin, me arsyetimin se fakti penal nuk ekziston. Për vendimin nr. ***, datë regjistrimi 27.10.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nuk ka të dhëna që vendimi të jetë ankuar dhe cila është ecuria e tij. Ndërsa vendimi nr. ***akti, datë regjistrimi 24.02.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, ka marrë formë të prerë, i paankimuar, në datën 05.02.2016.

Pavarësisht nga sa më lart, trupi gjykues, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk gjeti indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, në atë shkallë sa ta konsideronte subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm nga ana profesionale.

Sipas nenit 72, pika 4, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, aftësitë gjyqësore të gjyqtarit çmohen pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

28. Denoncimet nga publiku, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016

Pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit janë depozituar 10 denoncime. Për trajtimin e këtyre denoncimeve është marrë mendimi i specializuar edhe i Inspektoratit të KLD-së.

Gjatë shqyrtimit të tyre nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ka rezultuar se 6 denoncime kishin të bënin me fakte dhe rrethana që lidhen me vendimmarrjen e gjykatës në lidhje me marrjen e provave dhe interpretimin e zbatimin e ligjit në gjykimin e çështjeve ku ankuesit janë palë, të cilat zgjidhen më anë të shqyrtimit gjyqësor mbi apelimin gjyqësor të palës në gjykatat më të larta. Këto denoncime nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Në denoncimet e shtetasit M.B., me nr. *** prot., datë 08.01.2018 dhe I.B., nr. *** prot., datë 27.02.2018, rezultoi se çështja është objekt gjykimi në Gjykatën e Lartë dhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk mund të shprehet lidhur me bindjen e brendshme të gjykatës. Në mbështetje të nenit 72, pika 4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, aftësitë gjyqësore të gjyqtarit çmohen pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet.

Gjithsesi, u konstatua se Gjykata e Apelit Vlorë, me kryesuese subjektin e rivlerësimit, ka sjellë vonesa në zbardhjen e vendimit. Vendimi është dorëzuar i arsyetuar për një periudhë **prej 1 muaji dhe 3 ditësh**, nga të cilat 2 ditë gjyqtarja Brikena Ukperaj ka qenë me raport mjekësor 06.12.2017-08.12.2017. Zbardhja e vendimit në këtë afat është në tejkalim të afatit procedural të parashikuar nga neni 308 i Kodit të Procedurës Civile (**23 ditë tej afatit**), si dhe të afatit për ushtrimin e rekursit të parashikuar nga neni 443/2 i Kodit të Procedurës Civile (3 ditë tej afatit).

Me shkresën nr. ***, datë 01.06.2018, të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë është komunikuar vendimi i arkivimit të informacionit pas verifikimit për ankesën e shtetasit M.B.

Në dy denoncime të tjera të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit nga shtetasi LL.Z., denoncimi nr. *** prot., datë 14.12.2017 dhe E.H., denoncimi nr. *** prot., datë 03.01.2018, rezultoi se proceset gjyqësore civile janë zgjatur në kundërshtim me afatet e përcaktuara në pikën 5 të aneksit 1 të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. ***, datë 14.04.2010, “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve”.

Pavarësisht nga sa më lart, trupi gjykues, pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nuk gjeti indice apo elemente që mund të ngrinin dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit, në atë shkallë sa ta konsideronte subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm nga ana profesionale.

V. NJOFTIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT DHE VËZHGUESIT TË OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, në seancë dëgjimore në datën 20.06.2018, ora 11:00 paradite, në sallën e Pallatit të Kongreseve, në Tiranë, si hapi i fundit i procedurës së rivlerësimit.

Znj. Brikena Ukperaj mori dijeni dhe u paraqit personalisht në seancat dëgjimore të datës 20.06.2018 dhe 25.06.2018. Ajo nuk paraqiti prova apo pretendime gjatë kësaj seance, duke kërkuar rikonfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj (Lubonja), ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, dhe në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Brikena Ukperaj, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 25.06.2018.

KRYESUES
Komisionere

Xhensila PINE

RELATOR
Komisionere

Etleda ÇIFTJA

ANËTAR
Komisionere

Valbona SANXHAKTARI

Sekretare gjyqësore
Anisa DUKA